

# INFORMACION LIDHUR ME NGRITJEN E NJË PADIE

Keni qenë viktimë e një shkeljeje ? Keni ardhur për të ngritur padi ? Për mbarëvajtjen e punës së saj, Policia ka nevojë për informacione të sakta. Prandaj, për tu përgatitur mirë, lexojeni me vëmendje këtë dokument.

## Masat e para

- Mbani mend dhe shënoni menjëherë sinjalizimin e autorit
- Në rast vjedhjeje të kartave bankare, postare dhe/apo të kredisë, mendoni t'i bllokoni ato pranë institucioneve që i kanë lëshuar
- Në rast vjedhjeje të telefonit celular, bëni bllokimin e kartës SIM pranë operatorit përkatës
- Hartoni një inventar të hollësishëm të gjithçkaje që është zhdukur apo është dëmtuar
- Nëse keni imazhe të videosurvejimit, kujdesuni që t'i ruani ato në një suport elektronik
- Nëse vendi ku bëhet shkelja disponon një videosurvejim në të cilën ju nuk keni qasje, sinjalizoni policinë sa më parë që të jetë e mundur

## Informacione praktike

### Ku mund të ngrihet një padi penale ?

**Kur autori nuk njihet**, në linjë e në çdo kohë, për shkeljet e mëposhtme : vjedhje të thjeshta, vjedhje ciklesh, dëmtim prone. Shkoni në adresën e dhënë në shpinë të kësaj flete për të ndjekur procedurën. Në rast se keni pyetje, mund të kontaktoni postën e policisë suaj.

Për të gjitha shkeljet, në të gjitha postat e policisë së Zvicrës ; në Lozanë, mund të bëhet në postën e policisë së Flonit.

### Sa kohë zgjat regjistrimi i një padie penale ?

Mund të duhet një kohë pritjeje, nëse persona të tjerë janë paraqitur para jush. Në Lozanë, për ta shmangur një pritje të tillë, ka mundësi që të merrni takim me telefon. Sipas tipit të shkeljeve, duhet të llogarisni nga 30 minuta deri në tri orë për regjistrimin e një padie.

### Sa kushton ngritja e një padie ?

Kjo përçapje është falas. Por, ka shpenzime administrative për dokumentet e identitetit të humbura dhe/apo të vjedhura.

### Kush mund të ngrejë një padi penale ?

Çdo person i moshës 18 vjeç e sipër. Por edhe një i mitur, i prekur nga një shkelje, e ka sidoqoftë të drejtën për të ngritur padi, qysh nga mosha 12 vjeç, nëse është i vetëdijshëm.

### Cili është afati për të ngritur një padi ?

Afati është tre muaj qysh nga marrja dijani për autorin e shkeljes.

### A mund të mos pranohet regjistrimi i një padie ?

Jo, veç rasteve kur faktet e raportuara nuk përbëjnë shkelje penale (dëmtim mjete aksidetor apo mosmarrëveshje civile).

## Informacione të nevojshme për ngritjen e një padie

- Po qe e mundur, paraqitje e një dokumenti të identitetit (mbiemri, emri, data e lindjes, vendi i origjinës, profesioni, vendbanimi, telefonat, adresa elektronike)
- Emri i sigurimit që mbulon fatkeqësinë
- Data dhe ora e shkeljes
- Vendi i saktë
- Natyra e dëmtimeve (fotografi, preventiv e fatura nëse disponohen)
- Përshkrimi i hollësishëm i sendeve të zhdikurua, pikërisht i :
  - telefonave celularë (marka, modeli, n° i serisë IMEI)
  - dokumentet e identitetit (n°, data dhe vendi i lëshimit)
  - kartat e debitit dhe të kredisë (n°, institucioni lëshues dhe një ekstrakt i llogarisë në rast përdorimi mashtrues)
  - stoli (përshkrimi ose fotografi dhe vlerat)
- Për shkeljet në internet (siberkriminalitet), ruani të gjitha të dhënat (fotografi, shkëmbime mesazhesh, etj.

## Çfarë duhet ditur tjetër

### Çfarë bëhet me padinë penale ?

Një kopje i transmetohet ankueses/ankuesit bashkë me një njoftim informues. Dokumenti origjinal i transmetohet Policisë gjyqësore, nëse shkalja është bërë në Lozanë dhe është në kompetencë të saj. Në rastet e tjera, padia penale i transmetohet Policisë kantonale.

Paditësi/ja duhet pastaj :

- Të njoftojë sigurimin dhe t'i transmetojë një kopje të padisë.
- Të njoftojë policinë për çdo fakt të harruar apo për të cilin merr dijeni më vonë.

### Postën e policisë së Flonit

Rue de Genève 4

1003 Lausanne

Orari:

[www.lausanne.ch/police-contacts](http://www.lausanne.ch/police-contacts)

### Marrje takimi

+41 21 315 15 15

### Ngritje padie në linjë

[www.lausanne.ch/police-eplaine](http://www.lausanne.ch/police-eplaine)